

04

UDHËZUES XHEPI
PËR SIGURINË

MESSER 
Gases for Life

Transporti i sigurt i
akullit të thatë



I nderuar konsumator i gazeve Messer,

Përdorimi i CO2 të ngurtë (akulli i thatë) gjatë transportit të mallrave siguron mirëmbajtjen e zinxhirit të ftohjes dhe është veçanërisht i përhapur në transportin e produkteve ushqimore që prishen shpejt. Për të siguruar transport të sigurt kur përdorni CO2 të ngurtë, është e nevojshme të merren parasysh rreziqet e mundshme.

Kjo broshurë përmban udhëzime sigurie për përdorimin e CO2 të ngurtë gjatë transportit të mallrave që prishen shpejt, në lloje të ndryshme të kutive frigoriferike.

Ftohja e mallrave me akull të thatë rezulton në sublimimin (avullimin) e CO2, potencialisht duke krijuar një atmosferë të rrezikshme në pjesën e bagazhit të automjeteve. Pjesa e bagazhit, nëse nuk ventillohet mirë, konsiderohet një hapësirë e mbyllur, edhe gjatë ngarkimit dhe shkarkimit përmes derës së hapur.

Ne ju këshillojmë të jeni të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme gjatë trajtimit të CO2, të njiheni me të gjitha masat e sigurisë dhe t'i respektoni ato, përfshirë paragrafin 5.5.3 të Marrëveshjes Europiane ADR.

Ju lutemi rruani këtë fletë sigurie në mënyrë që ta aksesoni lehtë në çdo kohë.

E rëndësishme

Me çdo produkt, Messer ju siguron një fletë të dhënash sigurie që përmban udhëzime të rëndësishme sigurie mbi gazet. Ju lutemi të njiheni me këtë informacion.

Grupi Juaj Messer



Rreziqet e CO₂

Intoksikim dhe asfiksion

CO₂ i ngurtë sublimohet (avullon) dhe kthehet në CO₂ të gaztë. Edhe në përqendrime shumë të ulëta, CO₂ i gaztë do të ndërhyjë në veprimin metabolik të frymëmarrjes njerëzore dhe kimisë së gjakut. Përqendrimet e CO₂ aq të ulëta sa 1% në ajrin e frymëmarrjes mund të rezultojnë në përgjumje.

Në përqendrime prej 3% - 5% mund të shfaqen simptoma të barabarta me drejtimin e automjetit nën ndikimin e alkoolit. Një përqendrim prej mbi 10% CO₂ në ajër mund të shkaktojë edhe vdekje.

Djegjet kriogjenike

Nëse vjen në kontakt me lëkurën dhe sytë, ka mundësi të shkaktojë dëmtime për shkak të ftohjes ekstreme të akullit të thatë (-78.5 ° C).

Lëndime nga të presioni i tepërt

CO₂ i ngurtë sublimohet (avullon) në gjendje të gaztë me një raport zgjerimi mbi 845:1, duke shkaktuar potencialisht presion të tepërt dhe për këtë arsye ka rrezik të lëshohet me tepër presion nëse nuk ruhet në mënyrë të duhur.



Raste me potencial aksidenti

Aktivitetet kryesore me potencial rreziku për shkak të një atmosfere të rrezikshme CO₂ (rritje e përqendrimit të CO₂ dhe / ose mungesë e oksigjenit) në zinxhirin e furnizimit janë:

1. Ngarkimi i kontenjerit në hapësirën e mbyllur të automjetit
2. Transporti (drejtimi i automjetit)
3. Qëndrimi pa bërë gjë (mbajtja e pjesës së bagazhit mbyllur kur nuk jeni duke drejtuar automjetin)
4. Shkarkimi i kontejnerit nga hapësira e mbyllur e automjetit

Njerëzit mund të ekspozohen ndaj një atmosfere të rrezikshme CO₂ kur:

- Futen në hapësirën e mbyllur të automjetit midis ngarkesave (p.sh. shtimi ose heqja e ngarkesave, kontrollimi i ngarkesës).
- Mbyllen dyert e hapësirës së ngarkesës, me qëllim ose jo, kur ka një person brenda.
- Gjatë një aksidenti hapen dyert e hapësirës së ngarkesës dhe hyjnë brenda shërbimi i urgjencës.
- Një person mbyllet brenda automjetit gjatë ngarkimit ose shkarkimit.
- Mbyllen dyert e hapësirës së ngarkesës, me qëllim ose jo, dhe mbetet brenda një person në pamundësi për t'i rihapur ato (p.sh. për shkak të erës, ndikimit FLT, gabimit njerëzor)

- Hapen dyert e ndarësës, CO₂ i gaztë i grumbulluar në fund të hapësirës do të rrjedhë nga automjeti dhe do të rrethojë personat e afërt
- Hyni në pjesën e ngarkesës menjëherë pas hapjes së dymve mund të ketë një përqendrim të lartë të CO₂ aty.
- Hapësira e ngarkesës dhe kabina e shoferit nuk janë të ndara (jo hermetike).
- Krijohet hapësirë e mbyllur duke përdorur një kamion të ndarë (d.m.th të pajisur me një "portë që rrotullohet").

Nivelet e riskut

Niveli i riskut nga një atmosferë jo e sigurt për shkak të përdorimit të CO₂ të ngurtë si agjent ftohës gjatë transportit varet:

- Sasia e CO₂ të ngurtë brenda automjetit
- Lloji i ambllazhit dhe izolimit
- Temperatura e hapësirës së ngarkesës
- Ventilimi i automjetit
- Kohëzgjatja e mbajtjes së CO₂ të ngurtë në një hapësirë të mbyllur

Enë transporti për akull të thatë



Enë transporti enkas për akull të thatë, të izoluar mirë

Masat e sigurisë

Sigurohuni që nuk do ndohin aksidente duke ndërmarrë këto masa paraprake të sigurisë:

- Sigurohuni gjithmonë që ngarkesa të jetë e siguruar.
- Siguroni gjithmonë ventilim të mjaftueshëm, qoftë gjatë transportit ose para hyrjes në hapësirën e ngarkesës.
- Mos hyni në hapësirën e ngarkesës së automjetit menjëherë pasi të hapni dyert.
- Sigurohuni që askush nuk është brenda hapësirës së ngarkesës përpara se të mbyllni dyert.
- Nëse është e mundur shmangni hapësirat e mbyllura në hapësirën e ngarkesës.
- Shkarkoni fillimisht ngarkesat që janë në fund të hapësirës, duke vazhduar deri në pjesën e përparme për të mos hyr në hapësira të mbyllura.
- Filloni ngarkimin duke vendosur ngarkesat të pjesa e përparme e hapësirës, duke vazhduar deri në fund për të mos bllokuar dikë brenda.
- Në rast aksidenti informoni shërbimin e urgjencës që të mos hyjnë në pjesën e ngarkesës së kamionit menjëherë pasi të hapni dyert.

Kur hapni dyert, mos qëndroni përpara hyrjes.

- Siguroni dyert e hapësirës së ngarkesës në hyrje përpara se të futeni në automjet.
- Mundësisht dyert duhet të jenë të tilla që të hapen nga brenda.
- Mundësisht përdorni automjete ku kabina e shoferit të jetë e veçuar, "që mbyllet hermetikisht".
- Shmangni transportin e akullit të thatë në kabinën e një kamioni ose ndarjen e pasagjerëve të një veture. Nëse është e pashmangshme, ngarkesa duhet të izolohet mirë dhe të sigurohet, dhe duhet të mbahet ventilim i mjaftueshëm.

Rregullat e ADR-së

ADR (Marrëveshja Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme) parashikon rregulla për transportin me furgona / kamionçina që përfshijnë përdorimin e akullit të thatë si ftohës.

Nëse ka rrezik afiksimi, d.m.th. nëse automjeti nuk është i ventiluar mirë sipas ADR 5.5.3.3.3, ky rrezik duhet të tregohet me një njoftim paralajmërues në të gjitha pikat e hyrjes derisa automjeti të jetë ventiluar mirë dhe të jenë shkarkuar mallrat e ftohura ose të kondicionuara. Rekomandohet të merrni gjithmonë parasysh një atmosferë asfiksuese deri sa të kryhen teste me pajisjet përkatëse që tregojnë se atmosfera është e sigurt.



Kur përdorni CO₂ të ngurtë si ftohës ose për kondicionim, shenjat në automjete dhe në enë duhet të përputhen me ilustrimin e mëposhtëm *:

- Emri i ftohësit / kondicionerit duhet të tregohet në një rresht duke përdorur shkronja të mëdha jo më pak se 25 mm të larta. Nëse emri përkatës i transportit është shumë i gjatë për t'u vendosur në hapësirën në dispozicion, fonti i tij mund të zvogëlohet në madhësinë më të madhe të mundshme që përshtatet.
- Për më tepër, dokumentet e transportit duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm: UN (numër material)1845 DIOKSID KARBONI, I NGURTË, SI FTOHËS.
- Për më tepër, për drejtuesit kërkohen trajnime shtesë të përshtatshme për fushën e tyre të përgjegjësisë dhe në lidhje me rreziqet që lidhen me transportin.

Megjithatë, për një dërgesë të aprovuar që nuk është e ventiluar mirë, kërkesa themelore është që:

- të ndalohet shkëmbimi i gazit ndërmjet hapësirës së ngarkesës dhe kabinës së shoferit ose
- hapësira e ngarkesës të jetë e izoluar, e ftohur ose e ftohur mekanikisht, shiko ADR 5.5.3.3.3.

Me hyrjen në fuqi të ADR 2017, këto rregullore (ADR 5.5.3) vlejnjë gjithashtu për transportin tregtar të akullit të thatë edhe nëse nuk është duke u përdorur si ftohës. Megjithatë, dërgesat e tilla përjashtohen nga të gjitha kërkesat e tjera të ADR-së.

** Shënimi dhe emri në dokumentacionin e transportit duhet të jetë në një gjuhë zyrtare të vendit të origjinës dhe gjithashtu, nëse ajo gjuhë nuk është anglisht, frëngjisht ose gjermanisht, në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht, përveç rastit kur ka, nëse ka, marrëshje të lidhura midis vendeve të interesuara në operacionin e transportit që parashikojnë ndryshe*





Ju mund të kërkoni **udhëzues** shtesë **xhepi për sigurinë** në faqen tonë të Internetit ose t'i merrni ato direkt nga ekspertët tanë.

E rëndësishme

Ky udhëzues xhepi përmban vetëm informacione të përgjithshme. Nuk zëvendëson trajnimet dhe nuk është menduar si i tillë. Messer nuk mban përgjegjësi për informacionet që përmban kjo broshurë.

MESSER 

Gases for Life